



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:125879

Datë: 26.05.2023

Numri i dokumentit: 04329595

CN.nr.102/08

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtaren Kreshnike Zymberi Beqiri, në çështjen juridike të propozuesit S.S. nga fshati ... Komuna Ferizaj, kundër kundërpropozuesit S.D. nga fshati ... Komuna Ferizaj, në çështjen jo kontestimore rregullim mexhe, në seancën e datës 24.05.202 ka marr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PEZULLOHET** procedura jo kontestimore sipas propozimit të propozuesës S.S. nga fshati ... Komuna Ferizaj, e paraqitur kundër kundërpropozuesit S.D. nga fshati ... Komuna Ferizaj, në çështjen jo kontestimore rregullim mexhe.
- II.** Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, palët mund të iniciojnë procedurë kontestimore lidhur me këtë çështje.

A r s y e t i m i

Propozuesja S.S. ka ushtuar propozim për rregullim mexhe, kundër kundërpropozuesit Sami Demqi, për çështje juridike rregullim mexhe.

Gjykata me qëllim të shqyrtimit të çështjes, ka caktuar seancën për shqyrtimin e çështjes në vendin kontestuese e cila është caktuar dhe mbajtur me datë 24.05.2023, në të cilën ka prezentuar i autorizuari i propozuesës dhe personalisht kundërpropozuesi ka deklaruar për këtë çështje vijat kufitare janë te caktuara dhe çdo ndryshim tjetër është i pa pranueshëm, e ka kontestuar çdo matje tjetër eventuale për këtë pronë.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se mes palëve është kontestuese pjesa e pronës në të cilën kërkohet rregullimi i mexhës, pasi që nga procesverbalet nga seancat e kaluara shihet se pala kundërpropozuese asnjëherë nuk ka prezentuar në seanca gjyqësore, andaj me qenë se mes palëve është kontestuese vija kufitare mes parcelave kadastrale ...-0 dhe ...-0, ka vendosur që procedurën jo kontestimore ta përfundoj dhe palët i ka udhëzuar që procedurën lidhur me këtë çështje ta vazhdojnë në procedurë kontestimore konform nenit 210 të LPJK-së ku thuhet: *“Në qoftë se ndërmjet pjesëmarrësve në procedurë ekziston kontesti për sipërfaqen kufitare vlera e të cilës e kalon vlerën e kontestit të vlerës së vogël në procedurën kontestimore, e nuk arrijnë marrëveshjen në kuptimin e paragrafit 3. të nenit 209. të këtij ligji, gjykata do ta udhëzojë iniciuesin e procedurës që me padi të iniciojë*

procedurën kontestimore me qëllim të zgjidhjes së kontestit. Në këtë rast procedura jokontestimore përfundon pa vendim meritor''.

Neni 16 i LPJK-së ka përcaktuar në rastet kur është kontestuese mes palëve procedura jo kontestimore se si duhet vepruar ku thuhet se: *''Në qoftë se gjykata gjatë zhvillimit të procedurës jokontestimore konstaton se procedura duhet të zhvillohet sipas rregullave të procedurës kontestimore, ajo duhet të vendos pezullimin e procedurës me anë të aktvendimit''.*

Andaj, bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës, pretendimet e palëve dhe dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata ka pezulluar procedurën jo kontestimore sipas propozimit të propozuesës S.S., të paraqitur kundër kundërpropozuesit S.D., për çështjen juridike rregullim mexhe dhe palët i ka udhëzuar që pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, të iniciojnë procedurën kontestimore, pasi çështja objekt shqyrtimi me qenë se është kontestuese mes palëve është e rregulluar me dispozita të Procedurë Kontestimore.

Andaj, nga të lartcekurat bazuar në nenin 210 lidhur me nenin 16 të LPJK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
CN.nr.102/08, me datë 24 maj 2023

Gjyqtarja
Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.